



Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime e Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjiilan,

shpall këtë:

Thirrje për aplikim për shkëmbim të stafit në Universitetin "Celal Bayar" Manisa, Turqi

Universiteti Publik "Kadri Zeka", është pjesë e projektit KA107 ICM, 2022-2027, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Manisat "Celal Bayar" University në Turqi.

Programi Erasmus + KA107 ose shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar nga projekti që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të "Celal Bayar" University në Manisa nga Turqia dhe Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjiilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e stafit nga Universiteti "Kadri Zeka" - Gjiilan për studim dhe trajnim / veprimtari nga të gjitha njësitë akademike dhe administrative të UKZ-së

Shpenzimet e mbuluara nga projekti:

- Shpenzimet e qëndrimit dhe të udhëtimit janë të përcaktuara sipas marrëveshjes për projektin në fjalë dhe sipas **Distance Calculator** të Erasmus+ (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm).
- Granti i udhëtimit do të paguhet pas lëvizjes në universitetin përkatës.

Shënime të rëndësishme:

- Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore, pasi që nuk ka fonde shtesë.
- Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.



Kriteret për aplikim për stafin:

- Të jeni mësimdhënës i rregullt në UKZ ose, në rast të stafit administrativ, të keni kontratë valide pune në UKZ.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- **Kontrata e punës** (që dëshmon se jeni staf i rregullt i UKZ-së ose staf administrativ);
- **CV në gjuhën angleze** (ku përfshihen edhe punimet shkencore, si dhe të arriturat e tjera dhe përvojat e punës);
- **Kopje e pasaportës** (faqja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale) ose letërnjoftimit;
- **Letër motivimi** (në gjuhën angleze);
- **Dëshmi për njohuri të gjuhës angleze.**

Përzgjedhja bëhet sipas këtyre kriterëve:

- **50% - Përputhshmëria e fushës së ligjërimit me fushat e ofruara nga universiteti pritës**, si dhe fusha juaj e veprimit në UKZ;
- **50% - Njohuritë e gjuhës së huaj.**

Procedura e aplikimit:

1. Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike), prej datës **07.03.2025 deri më 14.03.2025**. Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.
2. Në këtë thirrje do të pranohen tre(3) staf nga UKZ. Të drejtë aplikimi kanë stafi akademik dhe administrativ.
3. Të gjithë aplikantët duhet të sigurojnë dëshminë/certifikatën e gjuhës angleze: niveli C1 për stafin akademik dhe B1 për stafin administrativ.
4. Aplikantët të cilët kanë qenë pjesë e mobilitetit në të kaluarën nuk kanë përparësi ndaj aplikantëve që aplikojnë për herë të parë në thirrje të këtij lloji (ata do të kuotohen me pikë negative nga komisioni).
5. Formularin e aplikimit e gjeni në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime të cilin e plotësoni gjatë dorëzimit të dokumenteve tjera të kërkuara.
6. Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net.

Për çdo informacion shtesë, kontaktoni Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime në UKZ.

Me respekt,

Prof. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte